

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	622-24-6638-2-2-3
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit: *“Hartimi i projektit detal i udhëkryqeve në disa pjesë të qytetit , në Arbanë, Bazhdarhane , Dardani Hartimi i projektit detal për funksionalizimin e rrugës Adem Jashari”.*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Florije Jahaj B.I / NTSH INFRATEK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. C, Nr. 30, Matican

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

00383 38 606 808

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Veton JAHAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@infratek.eu

(Adresa elektronike)

20.05.2025

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë: 02.07.2024
Njoftimi mbi vendimin dt.30.08.2024
Kërkesa për rishqyrtim dt.04.09.2024
Vendimi Për refuzim dt.06.09.2024
Ankesa dt.11.09.2024
Ekspertiza e OSHP -së dt.05.10.2024 Nr.2024/0835
Vendimi i OSHP-së dt.11.12.2024 Nr.2024/0835
Njoftimi mbi vendimin i dt.17.01.2025
Kërkesa për rishqyrtim e dt. 21.01.2025
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 24.01.2025
Ankesa e dt. 29.01.2025
Ekspertiza e OSHP -së dt.06.02.2025, Nr.2025/0077
Vendimi i OSHP-së dt.17.04.2025, Nr.2025/0077
Kërkesa për rishqyrtim e dt. 08.05.2025
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 13.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 71 i LPP-së

Neni 80 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 55 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Vendimi i OSHP-së nr.0835/2024, i dt.11.12.2024

Vendimi i OSHP-së nr.0077/2025, i dt.17.04.2025.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Para se ti shtjellojmë pretendimet tona ankimore, po e informojmë OSHP se autoriteti kontraktues është duke e ekzekutuar projekti që ka të bëjë me këtë tender edhe pse procedura e ankimimit është duke vazhduara. Ne kemi dal në teren dhe kemi bërë foto nga terreni vërehet ekzekutimi i punimeve të këtij projekti:

Ju lutem shikoni fotot e mëposhtme që janë bërë nga ana jonë:









Këto veprime të AK-së përbëjnë shkelje thelbësore të LPP-së dhe mosrespektim të vendimeve të OSHP-së, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të merren masa ndaj zyrtarëve kompetent të AK-së dhe njëkohësisht këto veprime ne do ti denoncojmë në organet e hetuesisë pasi që në këtë rast ka elemente të veprës penale.

Kronologjia e aktivitetit të prokurimit me pretendimet ankimore:

Fillimisht po e sqarojmë se njoftimi për konkursin e projektimit është publikuar me dt. **02.07.2024**, kurse njoftimi mbi vendimin e AK-së B58 ishte publikuar me dt.30.08.2024, ku ishte rekomanduar për kontratë **"PROing&Partners" SH.P.K**, ndërsa neve na ishte dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Kundër njoftimit mbi vendimin e lartcekur, ne me dt. 04.09.2024 kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim e cila ishte refuzuar nga ana e AK-së dhe më pastaj kemi vazhduar me parashtrimin e ankesës në OSHP me dt.13.09.2024. Në lidhje me ankesën tonë është nxjerr ekspertiza nga eksperti teknik me dt.05.12.2024, ku i njëjti e kishte aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe kishte rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim. Pas ekspertit teknik, paneli shqyrtues i OSHP-së ka nxjerr vendimin e saj me **nr. 2024/0835 me dt.11.12.2024**, në lidhje me ankesën tonë, ku i njëjti e kishte aprovuar ankesën si të bazuar, është kërkuar që të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues e ka kthyer lëndën në rivlerësim, mirëpo e njëjta ka tejkaluar të gjitha afatet

kohore për rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit. E njëjta me dt.17.01.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e saj, ku përsëri ka rekomanduar për kontratë OE "PROing&Partners" SH.P.K edhe pse i njëjti OE me vendimin e lartcekur të OSHP-së është cilësuar si OE i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Kundër vendimit të lartcekur ne përsëri kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK-ja dhe ankesë në OSHP, ku për të njëjtën ankesë është nxjerr përsëri ekspertiza nga eksperti shqyrtues me dt.06.02.2025, ku lënda është trajtuar si çështje e gjykuar (res-judicata), për shkak se pretendimet tona ankimore janë trajtuar në vendimin 2024/0835 të dt.11.12.2024. Pas ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues i OSHP-së ka nxjerr vendimin me nr. 2025/0077 me dt.17.04.2025, në lidhje me ankesën tonë, ku i njëjti panel e kishte aprovuar ankesën tonë si të bazuar, dhe lënda është kthyer në rivlerësim, me arsyetimin se ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar "**Res Judicata**".

AK-ja përsëri për herë të tretë me dt.06.05.2025 ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e saj, ku përsëri ka rekomanduar për kontratë OE "PROing&Partners" SH.P.K., edhe pse i njëjti me vendimet e lartcekura të OSHP-së është cilësuar si OE i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues në njoftimin mbi vendimin e saj e ka bashkangjitur edhe një procesverbal të rivlerësimit të bërë me dt.02.05.2025, duke e kontestuar kështu edhe ekspertizat e ekspertit teknik të kësaj fushë të prokurimit dhe atij shqyrtues dhe njëkohësisht edhe vendimet e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Në procesverbal ashtu sikurse edhe në njoftimin mbi vendimin e kaluar e edhe tani nuk është dhënë asnjë argument i bazuar në dispozita ligjore, mirëpo pothuajse i gjithë rivlerësimi është arsyetuar se mungesat në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, nuk mund të quhen mungesa sepse kërkesat e detajuara nuk janë pjesë e detyrës projektuese në këtë fazë mirëpo në fazën e hartimit të projektit detal. Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm, për më tepër është tendencioz dhe favorizues për OE të rekomanduar për kontratë, sepse në këtë rast të gjitha gjetjet tona në lidhje me mungesat në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë janë dashur të vendosen tani në këtë fazë.

Ky arsyetim i AK-së edhe një herë po e tregon qartë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminimin që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe që është dashur të rekomandohemi për kontratë.

Autoriteti kontraktues po vazhdon me praktikën e njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e kaluar të dt. 17.01.2025, ku me arsyetime të njëjta po mundohet ta favorizoj OE të rekomanduar për kontratë me çdo kusht. Në këtë rast nuk po respektohen ekspertizat e ekspertit teknik dhe atij shqyrtues dhe njëkohësisht edhe vendimet e panelit shqyrtues. Kjo qasje e AK-së dëshmon një mungesë të qartë të paanshmërisë dhe një tendencë për të anashkaluar proceset e rregullta të vlerësimit.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues nuk po i respekton vlerësimet profesionale të ekspertit teknik dhe atij shqyrtues, si dhe vendimet e Panelit Shqyrtues, të cilat janë të detyrueshme për autoritetin kontraktues.

Me vendimet e OSHP-së janë aprovuar të gjitha pretendimet tona ankimore, andaj me këtë rast nëse autoriteti kontraktues nuk do të veproj konform rekomandimeve të ekspertit teknike dhe atij shqyrtues dhe vendimeve të panelit shqyrtues, pa dashur që një gjë e tillë të cilësohet si kërcënim, ne jemi të detyruar të kërkojmë nga OSHP që konform nenit 131 të LPP-së të shqiptojë gjobë autoritetit kontraktues për mos respektim të vendimit të OSHP-së Nr.0835/2024, i dt.11.12.2024; dhe njëkohësisht do të kërkojmë nga OSHP, që ti drejtohen

KRPP që ti revokohet licenca ZPP për shkelje e rënda që janë bërë me rastin e mosrespektimit të vendimit të OSHP-së, sepse veprimet e AK-së bëjnë pjesë në shkeljet e rënda të cilat parashihen në pikën h) të nenit 97 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Pasi që ankesat tona janë cilësuar si të bazuara nga ana e OSHP-së me dy vendimet e saj dhe me ekspertizat nga ekspertit teknik dhe ai shqyrtues, mirëpo që të njëjtat nuk janë marr parasysh nga AK-ja, atëherë ne jemi të detyruar ti parashitrojmë edhe një herë pretendimet tona ankimore për papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë.

Sa për sqarim të gjitha konstatimet e AK-së të vendosura në njoftimin mbi vendimin e saj, janë pothuajse të njëjta nga njoftimet mbi vendimet e kaluara, ku në asnjë mënyrë AK-ja nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore dhe njëkohësisht nuk ka dhënë ndonjë dëshmi konkrete në lidhje me konstatimet e ekspertit teknik dhe atij shqyrtues dhe panelit shqyrtues të OSHP-së.

Pra siç e cekëm edhe më lartë ne edhe një herë po i parashitrojmë pretendimet kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, si në vijim:

Forma e përshkrimit është ndarë në dy forma për OE e rekomanduar për kontratë:

- Mos realizimi i FTD – detyrës projektuese dhe
- Niveli i projektit – vërejtjet në projekt

Referuar detyrës projektuese për dorëzimin e dokumentacionit, mungon forma digjitale e dorëzimit, pra mungon CD-ja e cila është obligative sipas dosjes.

PËRSHKRIMI I DETYRËS PROJEKTUESE IX. PËRMBAJTA E PROJEKTIT Projekti ideor arkitektonik dhe projekti kryesor për funksionalizimin e rrugës "Adem Jashari" dhe ish objektit të "Lirisë"- duhet të përmbajë: FAZA I	Kriteret e plot ësuar dhe të pa plotësuar
1. Regjistrin e koordinatave (Y, X, Z).	<input type="checkbox"/> PO <input checked="" type="checkbox"/> JO
2. Situacioni i gjerë 1:1000 a. Me ortofoto b. Pa ortofoto	<input checked="" type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO
3. Situacioni, zgjidhja urbanistiko-arkitektonike e lokacionit 1:500.	<input checked="" type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO
4. Zgjidhja urbanistike-arkitektonike e lokacionit 1:200.	<input type="checkbox"/> PO <input checked="" type="checkbox"/> JO

5. Gjatë gjithë fazës së punimit të projektit të prezantohen të gjitha ndërhyrjet në rrugë si dhe krahasimi i tyre me gjendjen ekzistuese (propozimi/ndërhyrjet dhe pjesët që do të ruhen): a. Zgjidhja urbanistike- arkitektonike – projekti i trases së rrugës (ekzistues dhe propozuar) 1:100 b. Zgjidhja urbanistike- arkitektonike – projekti i gjelbërimit (ekzistues dhe propozuar) 1:100 c. Zgjidhja urbanistike- arkitektonike – projekti i mobilitetit urban (ekzistues dhe propozuar) 1:100 d. Zgjidhja urbanistike- arkitektonike – projekti i Ndriçimit publik (ekzistues dhe propozuar) 1:100 e. Zgjidhja urbanistike- arkitektonike – projekti i instalimeve të ndryshme (ekzistues dhe propozuar) 1:100	<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO	<input checked="" type="checkbox"/>
6. Profilet karakteristike tërthore dhe gjatësore në përpjesë P= 1: 100.	<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO	<input checked="" type="checkbox"/>
7. Formati Digjital – CD.	<input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO	<input checked="" type="checkbox"/>

Sipas detyrës projektuese, respektivisht përmbajtjes së projektit FAZA 1, kriteret/pikat të cilat pretendojmë që nuk janë plotësuar nga OE i shpallur fitues nga komisioni vlerësues

Siç shihet nga përshkrimi lartcekur rrjedh që afërsisht 80% të detyrës projektuese nuk është plotësuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë.


Përveç tjerash, OE i rekomanduar për kontratë në materialin tejet të pakët të dorëzuar ka shumë gabime dhe lëshime teknike profesionale, ku në qoftë se do të ekzekutohej një projekt i tillë do të jetë tejet i shëmtuar dhe plotësisht jofunksional, prandaj ky OE ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Më poshtë do të cekim disa nga vërejtjet teknike të zgjidhjes:

Në mungesë të projektit digjital (CD_*DËG) vlerësimi është bërë vizuelisht pasi që nuk mund të nxirën dimensionet e sipërfaqe.

- Qasja e paraparë të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga rreth rrotullimi në parkingun e objektit komunal është e gabueshme dhe teknikisht e papranueshme.
- Gjeometria e rrethit (nuk dihet diametri) dhe tangjentet e rrugëve janë krejtësisht të gabuara sipas rregullave të projektimit të udhëkryqeve rrethore. Figura e më poshtme paraqet gjendjen e projektuar dhe rregullat bazike për projektim të udhëkryqeve rrethore.





It is almost never acceptable for an approach alignment to be offset to the right of the roundabout's center point. This alignment brings the approach in at a more tangential angle and reduces the opportunity to provide sufficient entry curvature. Vehicles will be able to enter the roundabout too fast, resulting in more loss-of-control crashes and higher crash rates between entering and circulating vehicles. Exhibit 6-18 illustrates the preferred radial alignment of entries.

Approach alignment should not be offset to the right of the roundabout's center point.

In addition, it is desirable to equally space the angles between entries. This provides optimal separation between successive entries and exits. This results in optimal angles of 90 degrees for four-leg roundabouts, 72 degrees for five-leg roundabouts, and so on. This is consistent with findings of the British accident prediction models described in Chapter 5.






Exhibit 6-18. Radial alignment of entries.

- Qasja në rrugën “Mon Çollaku” është trajtuar në mënyrë të gabuar. Përderisa e ka paraparë rrethrotullimin, nuk është dashur t’iu mundësohet kthimi i drejtpërdrejt por kthimi të bëhet nga rreth rotullimi.



- Ndriçimi publik nuk figuron në skicat e paraqitura (në situacion dhe në profila tërthorë)
- Stacioni i autobusëve i paraqitur në mes dy rrathëve të komunikacionit paraqet një zgjidhje jo racionale të qarkullimit në komunikacion pasi që shkakton ngulfatje të qarkullimit të trafikut. Po ashtu sipas skicës (në mungesë të materialit në formë digitale) gjerësia e hapësirës së stacionit vlerësohet të jetë jashtë çdo standardi.

Distanca minimale nga udhëkryqi (rrethi) deri te fillimi i stacionit të autobusëve duhet të jetë 20m' ndërsa gjerësia minimale duhet të jetë jo më e vogël se 3.5m.



Shpejtesia e qarkullimi	Nje autobus		Dy autobusa		Autobusi Harmonik	
	d=15.0 m		d=26.0 m		d=18.0 m	
V	L1	L	L1	L	L1	L
km/h	m	m	m	m	m	m
30	46.0	53.7	57	64.7	49	56.7
40	47	56.2	58	67.2	50	59.2
50	55	65.3	66	76.3	58	68.3
60	71	82.8	82	93.8	74	85.8


• Çdo kthesë e rrugës në aspektin gjeometrik duhet të projektohet me rreze sipas rregullave dhe standardeve të projektimit e jo kthesat me kënd të thyer (cep).

• **Gjerësitë e rrugëve** (shiriti i rrugëve) nuk kanë harmoni apo kontinuitet nga pika fillestare e deri te ajo përfundimtare si dhe gjerësitë e rrugëve nuk kanë harmoni mes vete, në skicat e prezantuara shihen zgjerime rrugësh të pakuptimta.

Projekti përfundimtar i paraqitur nga ana e kompanisë tonë. Ky është sipas detyrës projektuese ne harmonizim me gjendjen ekzistuese si dhe duke u bazuar ne normat dhe standardet teknike te avancuara.




Kodi : 0404



Me poshtë është paraqitur, projekti i shpallur fitues nga komisioni vlerësues. Pra ky projekt shifet qe nuk plotëson asnjë kriter dhe standard



5



Përfundim:

Bazuar në përshkrimin e lartcekur i cili është sipas dosjes së tenderit, lokacionit, normat dhe standardet rrjedh që projekti i përzgjedhur nuk e plotëson asnjë pikë si nga aspekti i detyrës projektuese e po ashtu edhe nga aspekti teknik

Përveç tjerash, mund të ketë shumë dyshime në profesionalizimin e komisionit vlerësues të cilët kanë arritur që një projekt të tillë ta shpallin fitues.

Nga ky vlerësim i ofertave kuptojmë se janë bërë veprime të shprehura në mënyrë subjektive dhe joprofesionale dhe njëkohësisht favorizim të OE të rekomanduar për kontratë dhe kështu këto dyshime tona i bazojmë në analizën që i kemi bërë projektit fitues si në aspektin e detyrës projektuese e edhe nga aspekti teknik.

Duhet cekur fakti se të gjitha pretendimet e lartcekura në vendimin e OSHP-së me nr.0835/2024 të dt.11.12.2024 janë cilësuar si të bazuara, andaj çdo arsyetim tjetër i AK-së në lidhje me pretendimet tona është i paqëndrueshëm. Njëkohësisht të gjitha pretendimet tona janë cilësuar si çështje e gjykuar me vendimin e OSHP-së, nr.0077/2025 të dt.17.04.2025.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.13.05.2025.

Edhe me këtë vendim, autoriteti kontraktues vetëm është munduar të arsyetojë vendimin e tyre dhe nuk ka dhënë asnjë arsye konkrete dhe faktike që oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e përgjegjshme.

Sa i përket shiritave të rrugëve arsyetimi është dhënë se është kërkesë e fazës së projektit kryesor e jo ideor, mirëpo sqarojmë se vlerësimi i ofertave është bërë për të gjithë mbi këtë bazë e po ashtu titulli i tenderit është hartimi i projektit detal.

Përgjigja e njëjtë është dhënë edhe për pretendimin ankimor në lidhje me gjeometrinë e rrethit dhe tangjentet, pretendimin qasjen në Rugen Mon Çollaku, stacionin e autobusëve dhe ndriçimin publik, duke i cilësuar si çështje të mëvonshme dhe që i takojnë projekti kryesor e jo ideor.

Në fund të vendimit të kërkesës për rishqyrtim AK-së ka dhënë konkluzionin si në vijim:

KONKLUZION I PËRGJITHSHËM

Të gjitha pretendimet e paraqitura, janë çështje që kanë natyrë teknike që duhet të adresohet në fazën e zhvillimit të projektit kryesor. Sipas nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik (Nr. 04/L-042), vlerësimi i ofertave mbështetet në përputhshmërinë me kriteret e dokumentacionit të tenderit. Në këtë rast, dokumentacioni nuk kërkon që në fazën ideore të jenë të zgjidhura përfundimisht çështje të tilla teknike. Prandaj, këto vërejtje nuk përbëjnë shkelje materiale të natyrës përjashtuese për projektin ideor.

Komisioni pas analizimit të pretendimeve dhe krahasimit të tyre me detyrën projektuese, dokumentacionin e tenderit dhe vendimit të OSHP: 2025/0077, rezulton se asnjë nga pretendimet e OE: Flori Jahaj nuk janë të bazuara. Procesi i tenderimit dhe vlerësimit ka qenë në përputhje të plotë me detyrën projektuese dhe kërkesat e AK.

Komisioni ka shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet dhe qëndron plotësisht pas vlerësimit të mëparshëm dhe kontrate propozon të shpërblehet i njëjti OE " PROing&Partners " SH.P.K., K.e Diellit Major M. Bushi Lam.12/11 Z. Perëndimi, 10000, Prishtinë ne vlere totale te ofertës 29000.00 Euro. dhe 80.92 pika.

Edhe me këtë konkluzion faktikisht pranohen lëshimet dhe gabimet në projektin e OE të rekomanduar për kontratë dhe me këtë nënkuptohet edhe përgjegjshmëria e këtij operatori ekonomik, mirëpo AK-së përsëri mundohet të arsyetojë veprimin e tyre për ta mbështetur këtë OE me çdo kusht.

Të mos plotësohet 80% e detyrës projektuese nga ana e OE të rekomanduar për kontratë dhe të shpërblehet kjo ofertë është më të vërtetë absurditet i llojit të vet dhe më këto veprime të AK-së i humb kuptimi edhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe detyrës projektuese.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është bërë poentimi i koncept projekteve në mënyrë objektive nga juria dhe komisioni i autoritetit kontraktues, prandaj vlerësimi duhet të bëhet edhe njëherë sepse siç u dëshmua më lartë koncept projekti i OE të rekomanduar për kontratë ka shumë mangësi dhe lëshime substanciale teknike dhe profesionale.

Realisht koncept projekti i OE të rekomanduar për kontratë është cilësuar i përgjegjshëm dhe i mangët nga paneli shqyrtues i OSHP-së, prandaj ky OE duhet të shpallet i përgjegjshëm automatikisht.

Është absurditet i llojit të vet të vlerësohet koncept projekti i OE të rekomanduar për kontratë me

80.92 pikë, ndërsa i yni me 65.12 pikë. Ky vlerësim është jashtë çdo norme profesionale dhe ligjore.

Në këtë rast kemi mos respektim edhe të nenit 80 të LPP-së, pasi që tek paragrafi 2 i kësaj dispozite shkruan qartë që Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit.

Procesi i vlerësimit nuk është bërë në mënyrë të pavarur dhe në mënyrë objektive, prandaj ky veprim i KA-së bie në kundërshtim me nenin 55 të RRPP Nr.001/2022, ku parashihet:

55.26 Juria do ta organizojë procesin e vlerësimit në atë mënyrë që të sigurohet integriteti dhe paanësia e procedurës. Juria do t'i vlerësojë projektimet vetëm në bazë të kriterëve të shënuara (pikët e peshës të shënuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit).

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** ankesa e OE ankues “**Florije Jahaj**” B.I. / **NTSH INFRATEK**
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së B58 për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**, kurse rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së.
- III. **DETYROHET** AK-së të respektojë vendimin e OSHP-së, nr.835/2024 të dt.11.12.2024 dhe vendimin nr. 2025/0077 të dt.17.04.2025.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*